

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Shkodër**, me objekt: “Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, aktivitetin ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve të qëndrueshme, dhënien me qira të objekteve, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, etj.”, lloji i auditimit: “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 171, datë 03.10.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 455/12, datë 03.10.2014, i ka rekomanduar z. Lorenc Luka, Kryetar i Bashkisë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1-Drejtorja Juridike dhe drejtoritë e tjera të Bashkisë, të kryejnë procedurat për ndërhyrje në rrugë ligjore për të gjithë debitorët, në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e detyrimeve debitorë të kontabilizuar.

Menjëherë

2-Spektori i policisë bashkiake të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e gjobave të vendosura nga policia bashkiake për vitin 2012-2013 dhe pa arkëtuar në shumën 1,723,000 lekë, duke u mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 10/279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”.

Vazhdimisht

3- Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Vendor të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e gjobave të vendosura për periudhën 2012-2013 në shumën 21,897,169 lekë, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar dhe pika 3 nenin 83, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Vazhdimisht

4-Bashkia Shkodër të marrë masa, për të arkëtuar 3 % e taksës së ndikimit në infrastrukturë në shumën **280.781** lekë për lejen zhvillimore me nr. 27, datë 11.6.2013, “Banesë tre kat + bodrum” me zhvillues, shoqëria “K.M.” sh.p.k. nga pronari Gj.P. dhe të kryejë tërheqjen e lejes zhvillimore, pasi është në kundërshtim me nenin 14 pika 8 të VKM nr. 314, datë 13.3.2013 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”.

Menjëherë

5- Bashkia Shkodër të marrë masa për evidentimin dhe kalimin e plotë në kontabilitet të pronave sipas VKM “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike që transferohen në Bashkinë Shkodër” si dhe regjistrimin e aseteve të marra, të cilat megjithëse janë regjistruar pjesërisht në ZVRPP Shkodër, nuk janë vlerësuar dhe pasqyruar në kontabilitet”.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

-Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, Bashkia Shkodër të nxjerrë aktet administrative, të bëjë rillogaritjet, të kryej kontabilizimet dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 113,840 **lekë** si më poshtë:

4-Për subjektin “A...” sh.p.k. në vlerën **113,840 lekë** për sa nga llogaritja e furnizimit sipas kontratës “Blerje karburant 2013”, të likuiduar, rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar për furniturën bazuar buletinit të APP datën 24 maj 2013 si rrjedhojë edhe vlefteja e likuiduar prej 4,965,957 lekë për sasinë e gazoilit D1 prej 27,660 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 175.42 lekë/litri që është 4,852,117 lekë duke sjellë një pagesë tepër prej 113,840 lekë. Kjo vlefte prej 113,840 lekë përfituar nga subjekti “A...” sh.p.k. e cila përbën dëm ekonomik është në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c dhe datë 31.12.2011 neni 4. “Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës.....ndryshon dukshëm, **me kërkesë me shkrim të palëve, pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD**” dhe nenin 3.2 të kontratës datë 20.6.2013.

Brenda muajit Tetor 2014

C. MASA DISIPLINORE

a-Në zbatim të nenit 72 pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, pika 3, mbështetur në kreu IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Shkodër, në cilësinë e autoritetit kontraktor, që për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike, të japë masën disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për punonjësit e mëposhtëm:

- 1- **E.D.**, kryetar i KVO, Drejtor i Prokurimeve.
- 2- **E.L.**, anëtar i KVO, Specialiste Buxheti.
- 3- **L.V.**, Anëtar i KVO.
- 4- **S.Z.**, anëtar i KVO, Administrimi Regjistrimit Territorit.
- 5- **A.Sh.**, Kryetar i KVO, Drejtor i Drejtorisë të Zhvillimit Territorit.
- 6- **E.G.**, anëtar i KVO.

Pasi:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje karburant 2012” nga auditimi i dokumenteve në formatin elektronik rezulton se subjekti “A...” sh.p.k. nuk ka në objektin e ekstraktit të regjistrimit tregtar “importin e naftës dhe nënprodukteve të saj” kurse “D...” sh.p.k. në objektin ka “import eksport...lëndë djegëse për automobilat” por në ofertat e tyre nuk kanë paraqitur raport analizimi para zhdoganimit për furniturën e tyre por për furniturën e subjektit “K...” sh.a. atë të datës 28.3.2012. Të dy këto subjekte duhej të skualifikoheshin dhe të anuloheshin tender dhe kualifikimi i operatorëve të mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 1. Datë 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç; “.....komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo që nuk janë me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik....” dhe kreut VII, pika 1, germa a, “Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në vijim të procedurës së hapur, kufizuar, konkursit të projektimit, kërkesës për propozim dhe

shërbimeve të konsulencës duhet të pranohen të paktën 2 oferta të vlefshme. Në të kundërt, autoriteti kontraktor ndërpret procedurën dhe fillon një procedurë të re, dhe, nëse kjo dështon përsëri, zbaton procedurat e parashikuara në nenin 32 ose 33, të LPP-së, nëse ekzistojnë rrethana të tilla.” dhe mbajnë përgjegjësi KVO.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Rriveshje asfalti dhe ndërtim trotuare Rruga “Industrial 1 Qyteti Shkodër”*, nga auditimi i dokumenteve në formatin elektronik rezulton se subjekti *“R... K... Tiranë”* sh.p.k. me ofertën 37,236,866 lekë pa t.v.sh. i kualifikuar, ka mangësi në dokumentacion si më poshtë:

Nga 4 kamionë të kërkuar nga autoriteti kontraktor, në kërkesat e veçanta të kualifikimit *“Mbi disponimin e mjeteve”*, operatori ekonomik *“R... K...”* ka paraqitur dokumentacion për 4 kamionë, por dokumentacioni i tyre, nuk plotëson kriteret për kualifikim pasi nuk është në përputhje me kriteret e veçanta të kualifikimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave nuk duhej të kualifikonte dhe klasifikonte ofertën e operatorit ekonomik *“R...K...”*.

Për sa më sipër nga KVO është kualifikuar operatori *“R...K...”* sh.p.k me ofertën 29,875,376 lekë pa t.v.sh. në kundërshtim me VKM nr. 1. Datë 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç; *“..... komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo që nuk janë me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik....”* dhe mbajnë përgjegjësi KVO.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Rikonstruksioni shkolla e mesme e përgjithshme “28 Nëntori”*, nga auditimi i dokumenteve në formatin elektronik rezulton se subjekti i skualifikuar *“G... & T...& N.B.”* sh.p.k. i ka paraqitur ato në përputhje me kërkesat e DST:

-kontratën e bashkëpunimit të me nr. 1727, rep, nr. 612 kol. dt. 21.9.2012, midis subjektit *“G...”* sh.p.k. i cili merr përsipër *“përgatitjen e dokumentacionit ligjor dhe teknik për pjesëmarrjen në tender ... duke kryer punimet në masën 80%”* dhe *“T...”* sh.pk. *“do të kryejë të gjitha punimet e instalimeve të ngrohjes dhe të MNZ të cilat përbëjnë 10%. (preventivi nr. 2 dhe preventivi nr. 1/C pika 1-6”, personit fizik N.B. do të bashkëpunojë në kryerjen e punimeve plotësuese në objektin sa më sipër me pjesëmarrjen në masën 10%, duke ndjekur pjesën e punimeve topografike në nivelin e shtresave të objektit në pikat e preventivit nr. 1/A pika 2 dhe 6”, të cilat përputhen me ndarjet në preventivin e ofertës të paraqitur sipas VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, kreut VII, pika 2, germa b; “... përcaktohen përqindja e pjesëmarrjes së punës..... dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi...”*.

-Formularin e sigurimit të ofertës me nr. 0112513, dt. 24.9.2012 nga shoqëria e sigurimeve *“S...”* në shumën 728,155 lekë për *“G... & T... & N.B.”* sh.p.k.

Për sa më sipër skualifikimi i operatorit *“G. & T... & N.B.”* sh.p.k. është në kundërshtim me VKM nr. 1. Datë 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç; *“.....komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo që nuk janë me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik...”* duke shkaktuar dëm ekonomik (31,994,506 - 27,472,925 = 4,521,581 lekë) dhe mbajnë përgjegjësi KVO.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Blerje karburant 2013”*, nga auditimi i dokumenteve në formatin elektronik rezulton se subjekti *“A...”* sh.p.k. nuk ka në objektin e ekstraktit të regjistrit tregtar *“importin e naftës dhe nënprodukteve të saj”* dhe në ofertën e tij nuk kanë paraqitur raport analizimi para zhdoganimit për furniturën e tyre por për furniturën e subjektit *“K...”* sh.a. atë të datës 27.5.2013. Kualifikimi i operatorëve të mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 1. Datë 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç; *“.....komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese, të përcaktuara në dokumentet e*

tenderit, apo që nuk janë me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik....” dhe kreut VII, pika 1, germa a, “Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në vijim të procedurës së hapur, kufizuar, konkursit të projektimit, kërkesës për propozim dhe shërbimeve të konsulencës duhet të pranohen të paktën 2 oferta të vlefshme. Në të kundërt, autoriteti kontraktor ndërpret procedurën dhe fillon një procedurë të re, dhe, nëse kjo dështon përsëri, zbaton procedurat e parashikuara në nenin 32 ose 33, të LPP-së, nëse ekzistojnë rrethana të tilla.” dhe mbajnë përgjegjësi KVO.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Bexhet Zeqiri, Milo Pano, Rajmond Koçi, Margarit Stefa, Nefail Xhepexhiu, Din Zeneli dhe Dorino Meçe më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT